




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE PRIVAT  
SHOQËRIA PËRMBARIMORE  
"STRATI BAILIFF'S SERVICE" Sh.p.k.



Adresa: Rr."Jordan Misja", P 141/1, Shk 1, Ap 7, Tiranë, Tel: 04 45 00 450, [www.stratibailiff.com](http://www.stratibailiff.com), [info@stratibailiff.com](mailto:info@stratibailiff.com)  
Cel: Gentian Strati: 0674000450; Valter Kaçupi: 0674000456; Kozeta Guri: 0674000455; Edvin Malotaj: 0674000457

Nr. 4745

Nr. 8052 Prot.

Tiranë, më 06.11.2018

Drejtuar : Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit Tiranë  
Për dijeni : Shoqërisë "2G-S Konstruksion" Sh.p.k.,  
Shoqëria "CAO Standart" Sh.p.k  
Lënda : Urdhër për vendosjen e sekuestros konservative

Në Tiranë, sot më datë 06.11.2018,

Unë **Edvin Malotaj**, përmbarues gjyqësor privat pranë shoqërisë përmbarimore "Strati Bailiff's Service" Sh.p.k., me NIPT L21825003E, i pajisur me çertifikatë Nr. 106, Maj 2012 lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore, në zbatim të "Urdhërit Ekzekutimit" Nr. 8100 Regj. Them., datë 19.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

**KONSTATOVA:**

Se në datë 06.11.2018 është depozituar kërkesa e palës kreditore dhe lidhur kontrata e shërbimit, pranë Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service" Sh.p.k., për ekzekutimin e titullit ekzekutiv *Faturat Tatimore të Shitjes*, për të cilat është lëshuar urdhëri i ekzekutimit Nr. 8100 Regj. Them., datë 19.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë;

Kreditor : Shoqëria "CAO Standart" Sh.p.k  
Debitor : Shoqëria "2G-S Konstruksion" Sh.p.k.  
Me Objekt : *Pagim fature*

Me vendimin Nr. 8100 Regj. Them., datë 19.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur:

*"Pranimin e kërkesës së kërkuarit Shoqëria "CAO Standart" Sh.p.k., me Nr. Regj. Them., 8100, datë regjistrimi 28.09.2018.*

*Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, për titujt ekzekutivë, fatura tatimore të shitjes: Nr. 420, datë 31.03.2018 në vlerën 68,000 lekë; Nr. 430, datë 08.04.2018, në vlerën 65,450 lekë; Nr. 450, datë 25.04.2018, në vlerën 63,750 lekë; Nr. 458, datë 03.05.2018, në vlerën 65,450 lekë; Nr. 474, datë 19.05.2018, në vlerën 17,000 lekë; Nr. 479, datë 24.05.2018, në vlerën 25,500 lekë; Nr. 438, datë 29.05.2018, në vlerën 62,900 lekë që ka debitori Shoqëria "2G-S Konstruksion" Sh.p.k., me Nipt L81513006L, me administrator Z. Gëzim Teta, me seli në Tiranë, Rruga "Koli Bano", Shk. 1, Ap. 5.*

Shpenzimet gjyqësore të përshkruar në faturën tatimore të shitjes në faturën tatimore Nr. 414, datë 19.09.2018 me përshkrimin "Shërbime ligjore për nxjerrje urdhër ekzekutimi në gjykatë, si dhe shpenzimet e tarifës gjyqësore në shumën 200 lekë, i ngarkohen palës debitore Shoqëria "2G-S Konstruksion" Sh.p.k., me Nipt L81513006L, me administrator Z. Gëzim Teta, me seli në Tiranë, Rruga "Koli Bano", Shk. 1, Ap. 5".

Me shkresën datë 06.11.2018 kreditori i është drejtuar Zyrës Përmbarimore që në zbatim të nenit 519 të K.Pr.Civile të vijojë me veprimet përmbarimore, pasi pala debitore mund të tjetërsojë pasuritë në pronësi të tij.

Sa më sipër bazuar në 527 e vijues të K.Pr.Civile, Ligjit Nr.10031 datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Privat" dhe Udhëzimit Nr. 385/7, datë 28.06.2017 "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor privat"

### URDHËROJ:

- 1- Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të vendosë masën e sekuestros konservative mbi aktivet e regjistruara pranë jush që zotëron pala debitore:
  - **Shoqëria "2G-S Konstruksion" Sh.p.k., me Nipt L81513006L**, për ekzekutimin e "Urdhërit të Ekzekutimit" Nr. 8100 Regj. Them., datë 19.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Këto aktive të qëndrojnë të bllokuara deri në një urdhër të dytë.
- 2- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- 3- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile.
- 4- Ky urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 ditëve.

**Përmbarues Gjyqësor Privat**

**Edvin Malotaj**

